

KONTRATË
PËR SHIT - BLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR
TË SHOQËRISË “ARTIZANES ” SH.P.K

Sot, më datë 21.01.2025 nënshkruhet kjo kontratë për shit-blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë ARTIZANES sh.p.k si më poshtë:

Teuta Ibrahimaj, shtetase shqiptare identifikuar me anë të Pasaportës me numër personal identifikimi F25825113A e datëlindjes 25.08.1952 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë “*Shitësi*”).

Dhe

Andri Ibrahimaj, shtetas shqiptare identifikuar me anë të të Pasaportës me numër personal identifikimi H60520073R i datëlindjes 20.05.1976 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë “*Blerësi*”).

MEQENËSE:

- A. **Teuta Ibrahimaj**, dëshiron ti shesë 100% të kuotave të kapitalit, që ajo zotëron në shoqërinë ARTIZANES sh.p.k.
- B. **Andri Ibrahimaj** dëshiron të blejë 100% të kuotave të kapitalit që **Teuta Ibrahimaj** zotëron në shoqërisë ARTIZANES sh.p.k.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, si dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit*” me ndryshimet e mëvonshme, referuar Statut të Shoqërisë ARTIZANES sh.p.k., si dhe mbi bazën e *Vendimit të Asamblesë së Ortakëve* të Shoqërisë, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. PËRMBAJTJA E KONTRATËS

1.1. Shoqëria ARTIZANES sh.p.k. është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas ligjit shqiptar, themeluar në datë 13.12.2021 me numër unik M12413020Q me kapital fillestar themeltar 100,000 (Një qind mijë) Lekë, pa ndryshime të mëtejshme të vlerës apo numrit të kuotave të kapitalit.

1.2. . Ortaki i vetëm i shoqërisë, “ARTIZANES” Sh.p.k., është Teuta Ibrahimaj zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (Njëqind mijë) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

1.3. Me vendimin e datës 21.01.2025 të Asamblesë së Ortakëve, të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar në masën 100% të tyre nga ana e ortakut të vetëm Teuta Ibrahimaj dhe blerja e tyre nga ana e blerësit, Andri Ibrahimaj.

2. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

2.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, shitja e masës prej 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë ARTIZANES sh.p.k nga ana e Teuta Ibrahimaj dhe blerja e tyre nga ana e Andri Ibrahimaj, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë të shitësit, mbi pjesët e kuotave e shitura si pasojë e këtij transaksioni shit-blerje.

2.2. Ndërsa blerësi, Andri Ibrahimaj bëhet pronar i kuotave të shitura më sipër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e kësaj kuote, duke fituar kështu cilësinë e ortakut të vetëm në shoqëri.

2.3. Pas realizimit të transaksionit të shit-blerjes së kuotave, kapitali ligjor i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë me vlerë përkatësisht 100,000 (Njëqind mijë) Lekë, që zotërohet nga ortaku Andri Ibrahimaj.

3. ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

3.1. Si çmim i këtij transaksioni Shit-Blerje kuotash të shoqërisë ARTIZANES sh.p.k do të jetë shuma prej 100,000 (Njëqind mijë) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë.

3.2. Sipas këtij përcaktimi, blerësi Andri Ibrahimaj do të paguajë në favor të shitësit, Teuta Ibrahimaj shumën në masën 100,000 (Njëqind mijë) Lekë.

4. DISPOZITA TË FUNDIT

4.1. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët, të cilat nuk mund të ndryshojnë kushtet e vendosura në të me pëlqimin e tyre.


4.2. Çdo mosmarrëveshje mes tyre palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.3. Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqip në përputhje të plotë me vullnetin e lirë të palëve në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

PALËT

Shitësi

Teuta Ibrahimaj



Blerësi

Andri Ibrahimaj



